



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016  
Nr. Dok. 201601683/2

**Lënda:** *Rekomandohet shqyrtimi i vlefshmërisë ligjore i AMTP nr.s'ka, datë 02.04.1999, i nxjerrë prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Kamëz, për trajtimin me tokë bujqësore të Familjes B, sipas Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën".*

**Drejtuar :** **Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë (KV)**

Adresa: Pranë Prefektit të Qarkut,

**TIRANË**

**Për dijeni :** **M.B.**  
Adresa:

**TIRANË**

I nderuar zotëri!

Institucioni i Avokatit të Popullit ka në proces shqyrtimi ankesën e shtetasit M.B., me banim në Kamëz, në të cilën prezantohet shqetësimi i moskryerjes së veprimeve, përgatitjes së dokumentacionit dhe dërgimit pranë ZVRPP, Tiranë, për sipërfaqen e tokës bujqësore prej 6000m<sup>2</sup> të fituar në pronësi sipas ligjit nr.7501, datë 09.07.1991 "Për tokën", të ndryshuar, me anë të AMTP nr.s'ka, datë 02.04.1999, të nxjerrë prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Çekrezë, Tiranë.

Referuar akteve të vëna në dispozicion prej ankuesit, rezulton se, ankuesi së bashku me familjen e tij kanë qenë dhe janë banor të Bashkisë, Kamëz, qysh para Vitit 1990, për pasojë referuar ligjit nr.7501, datë 09.07.1991 "Për tokën", të ndryshuar, VKM nr.255, datë 02.08.1991 "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore", ndryshuar me VKM nr.116, datë 21.03.1994, është trajtuar prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Çekrezë, Tiranë, me tokë bujqësore në pronësi sipas AMTP nr.s'ka, datë 02.04.1999. Dërgimi për regjistrim pranë ZVRPP, Tiranë, i AMTP nr.s'ka, datë 02.04.1999, referuar shkresës nr. s'ka, datë 30.05.2016, të ZVRPP, Tiranë, drejtuar ankuesit M.B.,

konstatohet se nuk ka ndodhur, kjo për shkak se, Njësia Administrative Zall-Herr, Zyra e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në shkresën nr.1438/1 Prot, datë 13.06.2016, drejtuar ankuesit, shprehet se; “... sipas vërtetimit të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Zall-Herr, ju nuk rezultoni banor i këtij Fshati më datë 01.10.1992, ashtu sikurse është e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore që pasuan ligjin nr.7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”.

Në zbatim të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi token bujqësore”, ju duhet t’i drejtoheni Komisionit Vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë, pranë Prefektit të Qarkut, Tiranë, për zgjidhjen e problemit tuaj”.

Për çështjen si më sipër prezantuar, ankuesi, shprehet, se, në Proces Verbalin datë 17.01.1997, të mbajtur në Komunën Zall-Herr prej Komisionit të ngritur prej Këshillit të Rrethit, mbi bazë të shkresës nr.2121 Prot, datë 16.01.1997, për verifikimin e tokës disponibël në fshatrat Dritas e Çekrez, të Komunës Zall-Herr, kanë rezultuar një numër ngastrash toke të pandara, nga të cilat, ankuesi, shprehet se ka përfituruar në pronësi sipërfaqen 6000m<sup>2</sup> sipas AMTP nr.s’ka, datë 02.04.1999, të nxjerrë prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Çekrezë, Tiranë.

Ndodhur në situatën si më sipërprezantuar, referuar parashikimeve të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore”, të ndryshuar, neni 7/a, lind nevoja shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore nga ana e këtij Komisioni, të AMTP nr.s’ka, datë 02.04.1999, të nxjerrë prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Çekrez, Tiranë.

Për arsyet e bërë me dije në këtë shkresë, Institucioni i Avokatit të Popullit bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenit 21/b, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.

## REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr.s’ka, datë 02.04.1999, të nxjerrë prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Çekrez, Tiranë, lëshuar në favor të Familjes së ankuesit M.B.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

*Me besim në bashkëpunimin tuaj.*

*Bashkëlidhur ju dërgojmë;*

*Kopje të AMTP nr.s’ka, datë 02.04.1999, të nxjerrë prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Çekrez, Tiranë.*

*Kopje të Procesverbalit datë 17.01.1997, të Komisionit të ngritur prej Këshillit të Rrethit, pranë (ish) Komuna Zall-Herr.*

*Kopje të shkresës nr.s'ka, datë 30.05.2016, të ZVRPP, Tiranë, drejtuar M.B.*  
*Kopje të shkresës nr.71/1 prot, datë 23.10.1998, të Bashkia, Kamëz, drejtuar M.B.*  
*Kopje të “Çertifikatë familjare” datë 24.06.2016, lëshuar për gjendjen familjare të Familjes B, nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr.11, Tiranë.*  
*Vërtetim datë s'ka i Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative Zall-Herr, për gjendjen familjare të Familjes B, më datë 01.10.1992.*  
*Kopje të Shkresës nr.1438/2 rpot, datë 13.06.2016, të Njësia Administrative Zall-Herr, Zyra e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, drejtuar M.B.*  
*Kopje të shkresës nr.2718/1 prot, datë 26.07.2016, të Komisionit të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, drejtuar M.B.*

**KOMISIONERI**

**Etilda GJONAJ(SALIU)**